

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

SESIONI I

VARIANTI B

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

Lënda: Ekonomi bërthamë

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

1. Një individ blen 10 obligacione me vlerë 1000\$ për çdo obligacion, për një periudhë 5 vjeçare, me një normë interesi 6% në vit. Norma e interesit do të merrej 2 herë në vit, një herë në qershor dhe një herë në dhjetor. Sa do të jetë shuma e parave që do të marrë individi në fund të vitit të pestë? **1 pikë**

- A) 3000
- B) 6000
- C) 10300
- D) 10600

2. Dy familje fqinjë kanë nga një biznes. Familja A e ka të trashëguar biznesin dhe përvoja ka bërë që të ketë shumë sukses. Familja B siguron të ardhura nga biznesi sa për të siguruar një jetesë normale. Një nga taksat që të dyja familjet i paguajnë shtetit është 10.000 lekë për familjen A dhe 3500 lekë për familjen B. Kjo taksë është mbështetur në parimin: **1 pikë**

- A) e barazisë horizontale
- B) e aftësisë për të paguar
- C) mbi vlerën e shtuar
- D) e përfitimit

3. Bankat e nivelit të dytë NUK: **1 pikë**

- A) japin kredi
- B) ofrojnë shërbime për kryerjen e pagesave
- C) shërbejnë si bankë e qeverisë
- D) ndikojnë në ofertën monetare

4. Instrumentet e politikës fiskale: **1 pikë**

- A) përdoren vetëm për të ngadalësuar ekonominë.
- B) përdoren vetëm për të rritur ekonominë.
- C) përdoren për të ngadalësuar ose rritur ekonominë.
- D) nuk ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë.

5. Domosdoshmëria e zgjedhjeve buron nga: **1 pikë**

- A) konflikti midis shitësve dhe blerësve
- B) boshllëku i mallrave dhe shërbimeve që prodhon ekonomia e një vendi
- C) kufizueshmëria e burimeve
- D) nevojat e kufizuara të individëve

6. Janë pengesa në tregtinë ndërkombëtare: **1 pikë**

- A) tarifatat, embargo, subvencionet, por jo kuotatat.
- B) tarifatat, embargo, kuotatat dhe subvencionet.
- C) tarifatat, embargo, kuotatat, por jo subvencionet.
- D) tarifatat, kuotatat, subvencionet, por jo embargo.

7. NUK përfshihet në forcën punëtore: **1 pikë**

- A) një programues kompjuterash.
- B) një mësues.
- C) një marangoz i papunë.
- D) një punonjës çeliku në pension.

8. Tabela e mëposhtme paraqet kërkesën dhe ofertën për mallin X. Në bazë të këtyre të dhënave ekuilibri i tregut për këtë mall është: **1 pikë**

- A) sasia ekuilibër 10 njësi; çmimi ekuilibër 3
- B) sasia e kërkuar 10 njësi; sasia e ofruar 3 njësi
- C) sasia ekuilibër 3 njësi; çmimi ekuilibër 3
- D) nuk përcaktohet në tabelë

Çmimi	Sasia e kërkuar	Sasia e ofruar
4	3	10
3	10	10
2	16	10

9. Nëse çmimi i qumështit në treg rritet, atëherë:

1 pikë

- A) kërkesa për akullore në treg do të rritet.
- B) kërkesa për akullore në treg do të ulet.
- C) oferta për akullore në treg do të rritet.
- D) oferta për akullore në treg do të ulet.

10. Kursimet varen nga:

1 pikë

- A) çfarë presin njerëzit t'u sjellë e ardhmja.
- B) normat e interesit bankar për depozitat e parave.
- C) niveli i taksave mbi të ardhurat e individit.
- D) të gjitha alternativat.

11. Tregoni tri përparësi të firmave individuale, përveç lehtësisë në organizim dhe taksave të ulëta.

3 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____

12. Supozojmë se jemi në treg. Çmimi i mallit zëvendësues në konsum u rrit në kushtet kur faktorët e tjerë mbeten të pandryshuar. Çfarë do të ndodhë në treg:

3 pikë

- a) me çmimin e ekuilibrit. _____
- b) me sasinë e ekuilibrit. _____
- c) Bëni paraqitjen grafike të kësaj situatë.


13. Në një treg të aksesorëve sportive çmimi i dorezave të raketave ka ndryshuar nga: 5 në 10 dhe sasia e kërkuar Q_d nuk ndryshon $Q_{d0}=Q_{d1}=80$.

3 pikë

- a) Sa është ndryshimi në përqindje të sasisë së kërkuar? _____
- b) Sa është ndryshimi në përqindje të çmimit? _____
- c) Gjeni nëse kjo është kërkesë elastike, joelastike, me elasticitet njësi/plotësisht elastike /plotësisht joelastike _____

14. Në kufirin e mundësive të prodhimit AB paraqitet diagrama e mëposhtme. Çfarë përfaqësojnë pikat X, Y, Z në lidhje me burimet:

3 pikë



- a) pika X _____
- b) pika Y _____
- c) pika Z _____

15. Tregoni si ndryshon oferta monetare në secilin nga rastet e mëposhtme: **3 pikë**

a) Banka Qendrore shet 20 milion Lekë Bono Thesari. _____

b) Banka Qendrore rrit normën e rezervës të detyruar nga 10% në 20%. _____

c) Banka Qendrore ul normën e interesit me zbritje nga 6% në 4%. _____

16. Jepni tre elemente që futen në llogaritjen e GDP me metodën e të ardhurave. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

17. Listoni tre treguesit kryesorë të ecurisë ekonomike të një vendi. **3 pikë**

a) _____

b) _____

c) _____

18. Shpjegoni tre argumentet kundër defiçitit buxhetor dhe borxhit publik në raport me: **3 pikë**

a) investimet _____

b) inflacionin _____

c) normën e interesit _____

19. Përmendni një shembull modeli të strukturave të tregut në formën: **3 pikë**

a) e konkurrencës së plotë _____

b) monopol _____

c) oligopol _____

20. Tabela e mëposhtme tregon sasinë e produktit që prodhohet dhe njësinë e punës të një firme. Duke ditur që madhësia e kapitalit është e fiksuar tregoni: **3 pikë**

Puna	0	1	2	3	4	5	6
Produkti	0	30	70	120	200	260	300

a) për cilën periudhë prodhimi bëhet fjalë? _____

b) sa është produkti mesatar fizik kur firma ka punësuar 4 punëtorë? _____

c) sa është produkti marxhinal kur firma ka punësuar 5 punëtorë? _____